REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

# RAPORT VJETOR PËR VLERËSIMIN E CILËSISË NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA

## Viti akademik 2021-2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA - TIRANË - UNIVERSITETI I TIRANËS

Hartoi NJSBC në FGJH :

| | |
|---|---|
| Prof. Asoc. Dr. Anida Kisi | Kryetare |
| Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali | Anëtar |
| Dr. Orges Selmani | Anëtar |
| Dr. Irena Pata | Anëtar |
| Dr. Marisa Janku | Anëtar |
| Msc. Edlira Jorgaqi | Anëtar |
| Dr. Viola Biti | Anëtar |
| Dr. Alban Foçi | Anëtar |

Student

| | |
|---|---|
| Ira Arapi | Anëtar |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I TIRANËS FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA - TIRANË -

LISTA E SHKURTESAVE

**IAL - Institucion i Arsimit të Lartë**
**MAS-Ministria e Arsimit dhe Sportit**
**FGJH - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**
**NJSBC - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë**
**GVB – Grupi i Vlerësimit të Brendshëm**

Tabela e lëndës


LISTA E SHKURTESAVE .......... 2

1. HYRJE .......... 4
2. NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË .......... 5
3. PROGRAMET E STUDIMIT DHE DIPLOMAT .......... 6
4. LIDHJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME TREGUN E PUNËS .......... 11
5. ORGANIZIMI I SHKOLLAVE VERORE/DIMËRORE 2021-2022 .......... 12
6. PERSONELI AKADEMIK .......... 13
   6.1 PYETËSORI "FORMULAR I VLERËSIMIT NGA PERSONELI AKADEMIK" (SHTOJCA NR. 1) .......... 13
7. KËRKIMI SHKENCOR .......... 15
8. PROJEKTE KERKIMORE .......... 18
9. BASHKËPUNIME DHE TRAJNIME .......... 20
10. VLERËSIMI NGA STUDENTËT (Pyetësori "Vlerësimi për lëndën dhe pedagogun nga studenti" SHTOJCA NR. 2) .......... 22
    10.1 KOMENTE DHE REKOMANDIME .......... 28
11. BURIMET E INFORMACIONIT/BIBLIOTEKA/E-LEARNING .......... 29
12. ZYRA E KARRIERËS DHE ALUMNI 2021-2022 .......... 29
13. INVESTIME IFRASTRUKTURORE NË SHËRBIM TË CILËSISË .......... 31
14. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .......... 31

Aneks .......... 34

Shtojca nr. 1 .......... 35

Shtojca 2 .......... 39

# 1. HYRJE

*Baza ligjore, konteksti dhe qëllimi i raportit*

Ky raport vjen në kuadër të politikave të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për sigurimin e brendshëm të cilësisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në dokumentet e mëposhtme:

- Ligji nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë (neni 6, 33, 38, 46, 87, 98, 99, 103, 104);
- Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë, VKM Nr. 531, datë11.9.2018, Shtojca nr. 2, 3 dhe 4
- Statuti i UT-së, 2018;
- Rregullore e UT-së, 2022;
- Rregullore për Sigurimin e Cilësisë e UT-së, 2020;
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT, 2022;
- Manuali i cilësisë në UT;
- Paketa e instrumenteve të të cilësisë, 2020;
- Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, 2022.

Të dhënat e pasqyruara në këtë raport do të jenë një instrument i rëndësishëm për Njësitë kryesore dhe ato bazë të FGJH për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe të programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.

Raporti paraqet të dhëna domethënëse për vitin akademik 2021-2022 të cilat janë tregues për cilësinë e veprimtarive akademike në FGJH si dhe të dhënat e përftuara nga anketimet e kryera në të njëjtin vit akademik për të dy ciklet e studimit, për të gjithë departamentet e FGJH-së të përmbledhura në raportet vjetore të cilësisë të njësive bazë në FGJH dhe nga të dhënat e pyetësorit "*Formular vlerësimi nga personeli akademik*" për vitin akademik 2021-2022.

Analiza dhe rekomandimet në mbyllje të raportit synojnë orientimin e veprimtarive në vazhdim për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.

Gjatë viti akademik 2021-2022 janë hartuar e miratuar një sërë dokumentesh të cilat synojnë organizimin cilësor të punës në FGJH. Më poshtë lista e tyre:

➢ **Akte rregullatore të miratuara më 21.12.2021**

1. Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja;
2. Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie;
3. Strategjia e Ndërkombëtarizimit;
4. Politikat e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit;
5. Strategjia dhe Politikat e Marketingut të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I TIRANËS FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA TIRANË

6. Studimi i Tregut të Punës për Studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja;
7. Rregullore Diplomimi e Programeve Studimore të Ciklit të Dytë Master i Shkencave;
8. Manuali i Praktikës Profesionale për Studentët e Ciklit të Dytë në Programet Master i Shkencave;

➢ **Akte rregullatore të miratuara më 24.06.2022**
1. Rregullore për Funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja;
2. Strategjia e Gjithpërfshirjes së Studentëve me Aftësi Ndryshe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

➢ **Akte rregullatore të miratuara më 01.07.2022**
1. Strategji të zhvillimit të Njësive Bazë
2. Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Njësive Bazë
3. Rregullore për Organizimin e Programit të Studimit të Njësive Bazë

➢ **Akte rregullatore të miratuara më 31.08.2022**
1. Rregullore e Brendshme e Punës për Funksionimin e Administratës së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

## 2. NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja është angazhuar në përmbushjen e detyrave të mëposhtme:

a. Zbaton politikën e UT-së për sigurimin e cilësisë;
b. Planifikon veprimtaritë monitoruese;
c. Organizon veprimtaritë periodike të monitorimit për zbatimin e legjislacionit, të rregulloreve dhe të udhëzimeve;
d. Planifikon vlerësimin e brendshëm në kuadrin e vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit;
e. Organizon veprimtari periodike të vlerësimit të cilësisë;
f. Bën planin e veprimit për veprimtarinë monitoruese dhe vlerësuese për çdo vit akademik;
g. Vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe shërbyese;
h. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, sipas kalendarit përkatës, organizon vlerësimin studentor për cilësinë e mësimdhënies;
i. Përgatit raportin vjetor për sigurimin e cilësisë;
j. Realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga njësia kryesore;
k. Përgatit paketën e vlerësimit të brendshëm;
l. Organizon veprimtaritë për përmirësimin e cilësisë;
m. Organizon trajnime për sigurimin e cilësisë me ekipin e vlerësimit të brendshëm, me personelin akademik, administrativ dhe me studentët;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË · FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA · UNIVERSITETI I TIRANËS · TIRANË

n. Ndan praktikat më të mira të sigurimit të cilësisë me të gjithë komunitetin e njësisë kryesore;
o. I asiston Ekipit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë të njësisë kryesore në përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm;
p. Informon komunitetin e njësisë kryesore dhe publikun për rezultatet e monitorimit, vlerësimit dhe të akreditimit nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit;
q. Krijon, pasuron dhe mirëmban sistemin e përpunimit dhe të ruajtjes së të dhënave të monitorimit dhe të vlerësimit të brendshëm;
r. Regjistron rezultatet e të gjitha monitorimeve, vlerësimeve dhe akreditimeve të njësisë kryesore dhe të programeve;
s. Bashkëpunon me NJSBC-në e UT-së për vlerësimin e brendshëm të njësisë kryesore dhe akreditimin institucional dhe të programeve;
t. Merr pjesë në programet e trajnimit që organizon NJSBC-ja e UT-së dhe ASCAL-i;
u. Bashkëpunon me NJSBC-të e njësive të tjera kryesore të UT-së për të shkëmbyer përvojën.

| Nr | Anëtarët e NJSBC | Detyra që ka në NJSBC |
|---|---|---|
| 1 | Anida Kisi | Kryetare |
| 2 | Aida Gjinali | Anëtar |
| 3 | Orges Selmani | Anëtar |
| 4 | Irena Pata | Anëtar |
| 5 | Marisa Janku | Anëtar |
| 6 | Edlira Jorgaqi | Anëtar |
| 7 | Viola Biti | Anëtar |
| 8 | Alban Foçi | Anëtar |
| Studentët e përfshirë në NJSBC (apo aktivitetet e saj) | | |
| | Emër Mbiemër | Detyra që ka në NJSBC |
| 1 | Ira Arapi | Anëtar |

## 3. PROGRAMET E STUDIMIT DHE DIPLOMAT

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja nëpërmjet programeve të tij synon përgatitjen, formimin dhe diplomimin e studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës, në shërbim të zhvillimeve dinamike në nivel kombëtar, rajonal, dhe evropian, duke ofruar një mjedis bashkëpunues që transmeton dhe zhvillon dijet nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Duke patur parasysh dhe në vëmendje dinamikat e zhvillimeve më të fundit, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka si mision ofrimin e programeve mësimore konkurruese bazuar në cilësinë e mësimdhënies dhe kurrikula bashkëkohore, orientimin e studentëve drejt të menduarit analitik dhe ndërdisiplinor dhe t'i përgatisë ata për tregun e punës. Programet e ofruara nga FGJH në të tria ciklet paraqiten në tabelën më poshtë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA - TIRANË - UNIVERSITETI I TIRANËS

**Cikli i parë i studimeve**

Programet e studimit "Bachelor" që ofrohen në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës janë organizuar në përputhje me ligjin nr. 80/2015 dhe në mbështetje të Strategjisë së UT-

| Fakulteti i gjuhëve të Huaja | (Viti akademik 2021-2022) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Numri i programeve profesionalë jouniversitar | Numri i programeve Bsc | Numri i programeve MSH | Numri i programeve MP | Numri i programeve MSc (Integruar) | Numri i programeve Dr |
| Departamenti i gjuhës Angleze | - | 1 program 3 drejtime | 1 program 3 drejtime | 1 program 1 drejtim | - | 2 |
| Departamenti i gjuhës frënge | - | 1 program 3 drejtime | 1 program 3 drejtime | - | - | 2 |
| Departamenti i gjuhës Gjermane | - | 1 program 3 drejtime | 1 program 3 drejtime | - | | 2 |
| Departamenti i gjuhës italiane | - | 1 program 3 drejtime | 1 program 3 drejtime | - | - | 2 |
| Departamenti i gjuhës Spanjolle | - | 1 program 1 drejtim | 1 program 2 drejtime | - | - | 2 |
| Departamenti i gjuhës Sllavo-ballkanike | - | 1 program 2 drejtime | 1 program 3 drejtime / 2 gj.ruse | -<br>- | | 2 |
| Departamenti i gjuhës greke | - | 1 program 1 drejtim | 1 program 1 drejtime | - | - | 2 |

së.

Programi i studimit Bachelor realizohet me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja e tij normale është tre vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare Bachelor në gjuhët dhe profilet përkatëse të studimit. Programet Bachelor ofrohen në lidhje me fusha si mësimdhënia, përkthimi, studime gjuhësore, letrare dhe kulturore, të cilat kanë për qëllim të formojnë specialistë të cilët aftësohen për të shërbyer në sektorin publik e privat. Studentëve gjithashtu u ofrohet mundësia për të vijuar studime të thelluara në fushat e komunikimit, përkthimit e mësimdhënies.

Programet e studimit janë organizuar në mënyrë të kujdesshme duke harmonizuar të gjithë komponentët përbërëse dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin e programeve të studimit (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018). Kurrikula e programit Bachelor ka pësuar ndryshime nën 20%, të cilat synojnë harmonizimin e programit me VKM 41 dhe plotësimin me kredite të provimit të diplomës. Këto ndryshime janë përcjellë për miratim pranë Drejtorisë së kurrikulave në rektoratin e UT-së.

Gjate vitit 2021-2022, programet e studimit Bachelor të ofruara nga të gjitha njësitë bazë iu nënshtruan procesit të vlerësimit të brendshëm.

Për procesin e vlerësimit të brendshëm për Akreditimin periodik të Programeve të Studimit "Bachelor" janë ndjekur të gjitha procedurat përkatëse me Agjensinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (ASCAL). Në muajin shkurt 2022, ASCAL ka përcjellë në Universitetin e Tiranës Agjendën e Procesit të akreditimit periodik të Programeve të studimit "Bachelor".

Të gjithë anëtarët e GVB-ve morën pjesë në një seri trajnimesh që u zhvilluan nga Rektorati i Universitetit të Tiranës me profesorë ekspertë të procesit të akreditimit për të marrë njohuri të hollësishme lidhur me hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm dhe për t'u njohur me dokumentacionin e nevojshëm për hartimin e tij.

Për hartimin e raportit Grupet e Vlerësimit të Brendshëm kanë zhvilluar takime me stafin akademik dhe administrativ, kanë analizuar bazuar në të dhënat cilësore dhe sasiore të mundësuara nga strukturat përkatëse, aktivitetet dhe veprimtaritë akademike dhe administrative duke evidentuar arritjet, rrisqet apo nevojat gjatë këtyre tre viteve në përmbushje të misionit të programit të studimit.

Raporti është i organizuar sipas 6 fushave të vlerësimit:

1. Ofrimi i programit të studimit;
2. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programeve të studimit të ciklit të parë bachelor
3. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat
4. Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit
5. Studentët dhe mbështetja e tyre
6. Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit

Dosjet e plota shoqëruar më dokumentacionin përkatës iu dorëzuan për vlerësim eksperteve të jashtëm të ASCAL-it për akreditim gjatë muajit korrik dhe vizitat e tyre në ambjentet e FGJH-së u zhvilluan gjatë muajit shtator 2022. Puna për vlerësimin e brendshëm ndihmoi në evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta në lidhje me këto programe studimi.

Në vitin akademik 2021-2021, falë bashkëpunimit të departamentit të Gjuhës Greke dhe Angleze u hap një program i ri në ciklin e parë të studimeve Bachelor në "Përkthim dhe Interpretim në gjuhën greke dhe angleze" me 20 kuota të parashikuara për vitin akademik 2022-2023 – 180 kredite me kohëzgjatje tre-vjeçare.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA - UNIVERSITETI I TIRANËS - TIRANË

**Cikli i dytë i studimeve:**

Në ciklin e dyte, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ofron programet:

a. Master i Shkencave në "Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë", 120 kredite, me kohëzgjatje 2 vjeçare. Qëllimi i këtij programi është formimi i mësuesve të gjuhës frënge.
b. Master i shkencave në "Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik", 120 kredite, me kohëzgjatje 2 vjeçare. Qëllimi i këtij programi është formimi i një figure të aftë profesionale për të përballuar dinamikën e marrëdhënieve ndërkulturore.
c. Master i shkencave në "Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim", 120 kredite, me kohëzgjatje 2 vjeçare. Qëllimi i këtij programi është formimi i përkthyesve dhe interpretëve profesionistë. Për vitin 2021-2022 këtë program e kanë ndjekur.
d. Master Profesional në Përkthim, 60 kredite me kohëzgjatje 1-vjeçare, qysh prej vitit akademik.
e. Masteri i Delokalizuar i Strasburgut në Gjuhë dhe Ndërkulturalitet, Specialiteti Përkthim Profesional dhe Interpretim, Dega Përkthim Profesional: 60 kredite me kohëzgjatje 1-vjeçare në dy semestra.
f. Në vitin akademik 2021-2021 u hap një program i ri Master i cili ofron dhe një Diplomë të dyfishtë Master i Shkencave me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Francë, në fushën Trajtimi Automatik i Gjuhëve, drejtimi: Trajtimi Informatik dhe Gjuhësor i Dokumenteve të Shkruara. Ky program adreson nevojat e karakterit lokal, kombëtar e më gjerë, duke marrë në konsideratë se formimi në Trajtimin automatik të gjuhëve bën më efikas formimet ekzistuese dhe nxit bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe ndërkombëtar (analiza sasiore dhe cilësore i informacionit në fusha të ndryshme studimi nëpërmjet digjitalizimit, etj.). Dimensioni digjital do të rikonceptojë metodat e mësimdhënies dhe të mundësojë aksesin në shumë mjete, burime dhe aplikacione. Qasja e integruar e programit bazohet në optikën e zhvillimit të qëndrueshëm, i cili mundëson njohjen e shpejtë të diplomave në rrjetin socio-ekonomik duke favorizuar teknologjitë e reja, me impakt të sigurt në zhvillimin e vendit dhe në integrimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Në lidhje me programet Master, gjatë vitit 2021-2022 janë ndërmarrë nisma për të harmonizuar dhe përshtatur më mirë masterin shkencor "Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë" dhe "Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik".

Programet e studimit Master i shkencave në "Mësuesi për arsimin e mesëm të lartë" janë programe të cilat ofrohen nga njësitë bazë të FGJH-së. Gjatë vitit akademik 2021-2022 u evidentuan të gjitha problematikat në planet mësimore të këtyre programeve në të gjitha departamentet e FGJH-së. Qëllimi i nxjerrjes së këtyre problematikave ishte pajtueshmëria me legjislacionin në fuqi, përkatësisht, me VKM nr. 41, datë 24. 01. 2018 dhe VKM 185, dt. 25. 03. 2021 " Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Për disa programe studimi rezultoi se nevojitej standartizimi i elementeve të programit të studimit sipas kategorisë dhe komponentit mësimor.

Problematika të tjera lidheshin me unifikimin dhe standartizimin e emërtimeve të lëndëve/ elementeve të planit mësimor në përputhje me ato të VKM-ve për të trija programet e ciklit të dytë. Për zgjidhjen e tyre, u ngritën grupe pune ndërdepartamentore, të përbëra nga pedagoget titullarë të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA - TIRANË

lëndëve, të cilët në përfundim të takimeve, dakordësuan emërtime të përbashkëta të këtyre lëndëve/elementeve të planit mësimor. Propozimet konkrete nuk u përcollën në Rektoratin e UT-së për shkak se propozimet e miratuara nga Senati Akademik i UT-së për ndryshimin në planin mësimor nën masën 20% të gruplëndëve psikopedagogjike të ofruara nga FSHS-ja ishin në papajtueshmëri me VKM-në. Plani mësimor i këtij programi studimi do të kalojë për riorganizim në masën mbi 20% në MAS pas nismës se MAS në lidhje me përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë për IAL.

Veprimtari të ngjashme me ato më lart janë zhvilluar gjatë vitit akademik 2021-2022 edhe për rishikimin e programit të studimit të masterit te shkencave në "Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor dhe turistik". Dy ishin arsyet kryesore që nxitën punën për ndryshimin në përmbajtje të këtij masteri: së pari, studimi i tregut i kryer nga FGJH, i cili vuri në dukje nevojën për të formuar ndërmjetës kulturorë në fushën e turizmit të cilët duhet të jenë të pajisur me kompetenca të cilat do të ofrohen në mënyrë më efikase me ndryshimet e propozuara. Grupet e punës kanë propozuar përbërjen e planit të ri mësimor i cili në vijim do të kalojë nëpër të gjitha procedurat e parashikuara për miratimin e programeve të riorganizuara në masën mbi 20%.

**Cikli i tretë i studimeve "Doktorata":**

Programet e studimit të doktoratës përfshihen në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor" dhe synon të nxisë kërkimin shkencor në një fushë të caktuar për të sjellë risi në mendimin shkencor dhe prurje me interes dhe dobi shoqërore.

Rregullorja e studimeve doktorale të FGJH (miratuar në 08.07.2022) parashikon një paketë aktesh si më poshtë:

- Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve ad hoc që kryejnë vlerësimin e aplikantëve;
- Modalitetet e aplikimit në studimet e ciklit të tretë;
- Kriteret vlerësuese (tabelat e pikëzimit);
- Formën e komunikimit të fituesve;
- Kontratën që lidhet mes udhëheqësit shkencor dhe doktorantit;
- Plani i ecurisë për vlerësimin gjatë përgatitjes së punimit doktoral;
- Rregulloren e funksionimit të komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor"

Hapja e ciklit të tretë të studimeve në fushat: "Shkenca Gjuhësore" dhe "Letërsi Botërore moderne dhe postmoderne", në prill 2022 u pasua nga:

- 45 kandidatë aplikues;
- 37 pedagogë të kategorisë Profesor u angazhuan me Projekte të hartuara në bazë të profilit të tyre dhe nevojave të njësisë bazë përkatëse.

Në datë 29.09.2022 u shpall lista paraprake e fituesve. Komisionet ad hoc shpallën 22 fitues me kandidatë nga të gjitha departamentet.

## 4. LIDHJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME TREGUN E PUNËS

Programeve të studimit të ofruara nga FGJF-së janë të hartuara bazuar në kompetenca (bazë të fushës/profesionale), të cilave u korrespondojnë rezultatet dhe aftësitë përkatëse të të nxënit që synojnë aftësimin vetjak dhe organizimit të pavarur, aftësimin shoqëror dhe komunikues, njohuri bazë të gjuhëve të studimit, njohuri rreth letërsisë, kulturës dhe historisë së vendeve gjuhën e së cilës studiojnë, aftësim për të kryer kërkim për çështje gjuhësore, letrare e kulturore, njohuri rreth çështjeve si komunikim ndërkulturor, kompetencë ndërkulturore, takime kulturore, mësimdhënie, përkthim dhe interpretim sipas profileve të studimit.

Për ciklin e parë, programet e studimit kanë për synim t'u japin dhe sigurojnë studentëve njohuri akademike, aftësi profesionale, kompetenca, si edhe aftësi të transferueshme, të cilat përbëjnë çelësin e suksesit duke ndikuar fort në zhvillimin e karrierës profesionale.

Diplomat e marra nga studentët e diplomuar në tërë ciklet e studimeve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja njihen në Evropë duke u krijuar mundësi për studime të mëtejshme dhe/apo punësim, jo vetëm në drejtimet dhe programet e studimit në FGJH por në një shumëllojshmëri programesh të tjera studimi.

Në ciklin e dytë, në tri programet e studimit, në vitin e dytë, semestri i dytë, studentët zhvillojnë praktikën profesionale (12 ECTS, 300 orë) pranë strukturave punëmarrëse në fushën e mësuesisë, të përkthimit dhe të komunikimit ndërkulturor dhe turistik. Praktika vlen për pajisjen e studentëve me aftësi profesionale dhe integrimin e tyre në tregun e punës.

Gjatë vitit 2021, FGJH ka kryer analizën e tregut të punës për të diplomuarit për vitin 2021. Për realizimin e këtij studimi janë përdorur disa mjete si analiza e të dhënave statistikore për tregun e punës në sektorin mësuesisë, statistika marrë sipas burimeve zyrtare për punësimin e përkthyesve në tregun vendas; pyetësor me aktorët kryesorë (agjencitë dhe operatorët) turistikë vendas; të dhëna të tregut për ofruesit e arsimimit mbi turizmin; pyetësor me studentët e diplomuar nga FGJH; si dhe analizë e të dhënave statistikore sipas burimeve zyrtare, për tregun e punës në sektorin e turizmit.

Në përputhje me perspektivën dhe vizionin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, analiza përcaktoi në mënyrë të qartë disa nga pikat e forta si edhe bëri sugjerime të duhura për t'iu përshtatur tregut aktual të punës në vendin tonë në tre sektorë: mësimdhënia, përkthimi dhe turizmi.
Nga analiza rezultoi se programet e studimit janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë.

Zyra e Këshillimit të Karrierës, kryen periodikisht mbledhje dhe analiza të dhënash në lidhje me studentët që ndjekin programet e studimit në FGJH, që diplomohen, si dhe gjurmon ecurinë e studentëve të FGJH-së, të cilat pasqyrohen në raportet vjetore të institucionit dhe u shërbejnë njësive përkatëse për analizë të mëtejshme të programeve që ofrojnë, sidomos në lidhje me tregun e punës dhe punësimin e studentëve.

FGJH organizon[1] dhe merr pjesë në shumë aktivitete që kanë si qëllim krijimin e një sinergjie midis botës universitare dhe tregut të punës. Ai merr pjesë dhe organizon panaire[2], zhvillon takime e workshop-e me institucionet[3]dhe subjekte të ndryshme për të diskutuar e ndarë mendime me komunitetin e biznesit dhe institucionet[4] që mund të jenë ofrues të vendeve të punës dhe studentëve dhe stafit akademik, me qëllim shkëmbimin e ideve dhe ballafaqimin midis kërkesave të tregut të punës dhe mundësive reale që ofrojnë programet e studimit.
Qëllimi final i këtyre takimeve është jo vetëm vënia në kontakt e studentëve me punëdhënësit potencialë, por edhe përshtatjen e kurrikulave dhe programeve në përputhje me tregun e punës.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja numëron sot 34 Memorandume bashkëpunimi me kompani apo institucione të ndryshme, në ndihmë të studentëve për të kryer "Praktikat Mësimore", por edhe për t'u punësuar pas përfundimit të studimeve;

Në qershor 2022 u zhvillua një pyetësor online me qëllim për të matur cilësinë e praktikës profesionale dhe mbi të gjitha cilësinë e bashkëpunimit me partnerët me të cilët kemi nënshkruar marrëveshje. Nisur nga rezultatet e këtij pyetësori del si objektiv lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione e kompani ndaj të cilave kemi marrë feedback pozitiv nga studentet tanë, në mënyrë që të zgjerojmë sa më shumë linjat e bashkëpunimit në përfitim të studentëve.

## 5. ORGANIZIMI I SHKOLLAVE VERORE/DIMËRORE 2021-2022

Shkollat Verore dhe Dimërore sjellin më afër studentëve praktikat më të mira të integrimit të kurrikulës me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu këto shkolla synojnë t'u mundësojnë studentëve të interesuar përvetësimin e gjuhëve që ata zgjedhin dhe njohuri që kanë të bëjnë me çështje historike, gjuhësore, letrare dhe trashëgiminë kulturore. Studentët kanë mundësi të shohin nga afër se sa profesione të bukura do të ushtrojnë në të ardhmen, duke iu referuar guidave turistike, ciceronëve, agjentëve kulturorë dhe turistik, përkthyeseve, etj.
Shkolla Dimërore e Gjuhës Kineze
Shkolla Verore e Gjuhës Bullgare
Shkolla Verore e Turizmit dhe e Kulturës
Shkolla Verore e Gjuhës Osmane

[1] https://www.ccifa.al/fr/les-assemblees/a-venir/e/event/event-le-forum-etudiants-et-entreprises.html
[2] https://fgjh.edu.al/lajmerim-panairi-ëork-study-07-04-2022-08-04-2022-muzeu-historik-kombetar-tirane/
[3] - https://fgjh.edu.al/ftesepjesemarrje-ne-panairin-e-punes-2022/
[4] https://www.auf.org/nouvelles/actualites/de-formation-a-professionnalisation-etudiants-albanais-realisation-daudio-guides-francais/

Shkolla e Vjeshtës Croaticum në Universitetin e Zagrebit

## 6. PERSONELI AKADEMIK

Personeli akademik i FGJH-së ka kualifikimin e kërkuar sipas kritereve të përcaktuara në aktet ligjore (Ligj Nr. 80/2015, Neni 59, pika 6) për titujt dhe gradat akademike të stafit akdemik që mbulon programin e studimit.
UT/FGJH ka nxitur kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimit të mëtejshëm profesional të stafit efektiv në universitete perëndimore në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të UT/FGJH me universitete ndërkombëtare, projekte mësimore-shkencore dhe bursave vetjake si: Erasmus+, Fulbright, Mevlana, marrveshje AUF etj. trainime në kurse specifike etj.
Personeli akademik efektiv në FGJH përbëhet nga 131 pedagogë efektivë për vitin 21-22, nga të cilët 41 janë me titullin Profesor, 72 me titullin Lektor dhe 13 me titullin As. Lektorë.
Gjatë vitit akademik 2021-2022:

- 13 kandidatë kanë fituar gradën shkencore "Doktor" (5 prej të cilëve janë pedagogë të brendshëm të FGJH-së.)
- 1 kandidat është në proces për të fituar gradën shkencore "Doktor".
- 12 kandidatë kanë fituar titullin "Profesor i asociuar"
- 3 kandidatë të FGjH-së
- 1 kandidat ka fituar titullin "Profesor"(jo personel i FGJH-së)
- Aktualisht 10 kandidatë janë në proces për fitimin e titullit "Profesor i Asociuar"

### 6.1 PYETËSORI "FORMULAR I VLERËSIMIT NGA PERSONELI AKADEMIK" (SHTOJCA NR. 1)

Vlerësimi nga ana e personelit akademik është kryer gjatë muajit korrik 2022. Vjelja e këtyre të dhënave është mjaft e rëndësishme pasi shpesh duke vënë në qendër vetëm studentin dashur padashur lëmë në hije një aktor mjaft të rëndësishëm të panoramës didaktike: pedagogun. Vjelja e të dhënave konsiston edhe në marrjen e informacioneve lidhur me kërkesat dhe problematikat që ata hasin në të përditshmen dhe sa ato zgjidhjen apo përmbushjen nga njësia bazë dhe ajo kryesore.

- Më poshtë janë paraqitur rezultatet e këtij pyetësori, të cilat gjenden në formë tabelore :

| **Pyetjet** | Shumë i kënaqur | I kënaqur | Nuk e di | I pakënaqur | Shumë i pakënaqur |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kombinimi i kërkimit, mësimdhënies dhe shërbimit në komunitet.** | 24% | 60% | 10% | 5% | 0% |
| **Stimulimi intelektual në punë.** | 26% | 57% | 5% | 12% | 0% |



REPUBLIKA E SHQIPERISË FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA - TIRANË UNIVERSITETI I TIRANËS

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Lloji i mësimdhënies/kërkimit që bëni aktualisht. | 37% | 54% | 5% | 2% | 3% |
| Ndërveprimi me studentët. | 57% | 37% | 1% | 4% | 0% |
| Bashkëpunimi me kolegët. | 45% | 47% | 5% | 3% | 0% |
| Këshillimi që keni në dispozicion. | 25% | 60% | 5% | 7% | 1% |
| Mbështetja administrative që merrni nga departamenti. | 63% | 34% | 3% | 1% | 0% |
| Qartësia në lidhje me procesin e promovimit të personelit akademik. | 37% | 44% | 11% | 5% | 1% |
| Perspektivat tuaja për avancimin dhe progres në karrierë. | 30% | 54% | 9% | 6% | 0% |
| Paga. | 15% | 6% | 27% | 35% | 15% |
| Siguria dhe qëndrueshmëria e punës në departament. | 42% | 43% | 4% | 11% | 0% |
| Sasia e kohës që keni në dispozicion për veten dhe familjen tuaj. | 19% | 61% | 7% | 12% | 1% |
| Atmosfera e përgjithshme në departament. | 37% | 53% | 6% | 5% | 1% |
| Sa i përdor departamenti përvojën dhe njohuritë tuaja. | 19% | 57% | 18% | 5% | 1% |

- Ka një pjesëmarrje rreth 50 % në plotësimin e këtij pyetësori gjë që tregon një interes mesatar të personelit akademik në përmbushjen e një detyrim institucional, por kryesorja në shprehjen e mendimit dhe opinionin personal në lidhje me një tërësi çështjesh që lidhen ngushtë me profesionin, karrierën etj.
- Rezultatet tregojnë se personeli akademik është shumë i kënaqur për sa u përket kombinimit të kërkimit, mësimdhënies dhe shërbimit në komunitet, stimulimit intelektual në punë, bashkëpunimit me kolegët, Këshillimi që keni në dispozicion.
- Personeli akademik është i kënaqur mbi 80% për sa u përket:
    - Ndërveprimit me studentët,
    - Mbështetjen administrative që marrin nga departamenti,
    - Perspektivat tuaja për avancimin dhe progres në karrierë,
    - Sasia e kohës që kanë në dispozicion për veten dhe familjen tuaj,
    - Atmosfera e përgjithshme në departament.
- Një e treta e të pyeturve nuk kanë dijeni në lidhje me procesin e promovimit të personelit akademik dhe përdorimit nga departamenti të përvojës dhe njohurive të tyre, gjë që kërkon një informim më të mirë në lidhje me mundësitë dhe veprimtaritë që lidhen me këto aspekte.
- Lidhur me pagën në vendin e punës rezulton se pjesa më e madhe e personelit akademik, 83% janë (shumë) të pakënaqur, por ajo që vihet re gjithashtu është se 17% e personelit nuk është në dijeni.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I TIRANËS - FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA - TIRANË

- Siguria dhe qëndrueshmëria e punës në departament rezulton e kënaqshme për 50 % të personelit akademik dhe 50 % e tyre janë shumë të pakënaqur me këtë pikë. Këto përqindje tregojnë se duhen gjetur arsyet e kësaj pakënaqësie dhe të reflektohet për trajtimin e tyre.

## 7. KËRKIMI SHKENCOR

Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur veprimtarinë shkencore në nivel njësie bazë dhe kryesore.

| **Produktet e Kërkimit Shkencor për çdo anëtar të njësisë bazë** | Gjuha Angleze | Gjuha Frenge | Gjuha Gjermane | Gjuha Italiane | Gjuha Spanjolle | Gjuhet Sllavo Ballkanike | Gjuha Greke | FGJH Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Artikuj të botuar në revista dhe/ose serial botimesh shkencore jo periodike | 9 | 6 | 6 | 6 | 3 | 2 | | 32 |
| Artikuj të botuar në revista të tjera ndërkombëtare | 19 | 12 | 14 | 7 | 5 | | | 57 |
| Monografi | | 1 | | | | | 6 | 7 |
| Referime shkencore nderkombetare | 27 | 13 | 22 | 6 | 5 | 3 | 3 | 79 |
| Referime shkencore kombetare | 21 | 14 | 10 | 23 | 2 | 2 | 4 | 76 |
| Botime | | 11 | | | | | | 11 |
| Pjesëmarrje në borde organizative dhe shkencore | 9 | 7 | 3 | 6 | 4 | 2 | 2 | 33 |
| Projekte | 19 | 14 | | 7 | 3 | | 2 | 45 |
| Trajnime /Leksione të hapura | 17 | 7 | | 7 | 2 | 7 | | 40 |
| Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare | 12 | | 3 | | | | | 15 |
| Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore) | 3 | | | 280 | 120 | | | 403 |
| Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit | | 1 | | 3 out/2 in | | 3 | | 4 |
| Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime | | | | 23/6 | | | | 0 |
| Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | | | | | 1 | | | 1 |
| Për punime shkencore individuale të pedagogëve | | | | 1 | | | | 1 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Për projekte shkencore në rang Departamenti | | 7 | | | 1 | | | 8 |
| Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë | 12 | 20 | | 2 | 4 | | | 38 |
| Mobiliteti i pedagogeve nga dhe drejt programit të studimit | 15 | 16 | 2 | 7 | 2 | 4 | 9 | 55 |
| Pjesmarrje ne komitetin organizativ te konferencave te organizuar nga UT-a dhe njesite perberese | 4 | 9 | 6 | 5 | 2 | 2 | | 28 |

Veprimtaritë me karakter shkencor të zhvilluara gjatë vitit akademik 2021-2022 në nivel njësie kryesore paraqiten në vazhdim:

- Konferenca shkencore ndërkombëtare me temë "Ridimensionimi i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në dinamikat e një realiteti të ri" me pjesëmarrjen e më shumë se 70 studiuesve akademikë vendas dhe të huaj, 9 dhjetor 2021,
- Konferenca Ndërkombëtare me titull: "Multilingual education in linguistically diverse context", me pjesëmarrjen e studiuesve të ndryshëm nga vende si: Amerika, Norvegjia, Qipro, Greqia, Italia, Anglia, Austria, Kazakistani, Polonia, Gjermania, Sllovakia, Sllovenia, Ukraina, Kina, Sudani, Hungaria, Turqia, Zvicra, Katari, Australia, Spanja dhe Suedia.
- Tryeza e rrumbullakët me temë: Përkthimi mision dhe pasion, me pjesëmarrjen e përkthyesve dhe padagogëve shqiptarë dhe Adele D'Arcangelo, Coordinatrice Laurea Magistrale in Specialized Translation, Università di Bologna, 30 shtator 2021.
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në bashkëpunim me Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë realizoi një konferencë shkencore ndërkombëtare me titull:"Quelle mise en valeur du patrimoine culturelle par la communication »?31 mars 2021
- Departamenti i Gjuhës Gjermane në bashkëpunim me Ambasadën Austriake në Tiranë, sollën në një format të veçantë ekspozitën "Stefan Cvajg – Autor Botëror" shoqëruar me kumtesa mbi këtë autor të një dimensioni botëror, i cili për idetë e tij është cilësuar si "pionier i Evropës së bashkuar". Aktiviteti u përshëndet nga Shkëlqesia e Tij Z. Christian Steiner, Ambasador i Austrisë në Tiranë dhe Prof. Dr. Esmeralda Kromidha, Dekane e FGJH-së, UT.
- Departamenti i Gjuhës Italiane për vitin akademik 2021-2022, me mbështetjen e Ambasadës Italiane në Shqipëri organizoi në datën 21 Tetor 2021 konferencën ndërkombëtare me titull: "A 700 anni dalla morte di Dante: prospettive di studio tra Albania e Italia», në ambientet e FGJH njëkohësisht edhe online. Pjesëmarrësit në konferencë ishin studiues shqiptarë dhe italianë.
- Në datat 15-16 dhjetor 2021, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, u organizua Simpoziumi Ndërkombëtar "Mehmet Akif Ersoj dhe vepra e tij". Më 20 shtator 2021 u zhvilluan "Takimet shkencore shqiptareruse". Kjo veprimtari e përbashkët synon njohjen më të mirë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA - TIRANË UNIVERSITETI I TIRANËS

të albanologjisë ruse në Shqipëri dhe zhvillimin e mëtejshëm të lidhjeve të albanologëve rusë me institucionet albanologjike shqiptare dhe me studiuesit shqiptarë.

- Në datën 14 shkurt, studentët e Departamentit të Gjuhës Greke organizuan telekonferencën "Mësimdhënia në gjuhën greke" me studentët e Departamentit të Arsimit Parashkollor të IEK Dimitra.
- Departamenti i Gjuhës Frënge, organizoi dy konferenca në datën 18 mars 2022:
- Prezantimi i konferencës së Prof. Frederikos Valetopoulos me temë: "Përcaktimi i kompleksitetit leksikor dhe sintaksor përmes korpuseve të nxënësve";
- Zhvillimi i konferencës së Prof. Stéphanie Gobet me temë: "Mësimi i frëngjishtes së shkruar nëpërmjet një gjuhe burimore të folur: kategorizimi i gabimeve".
- Në kuadër të Ditës Botërore të Gjuhës Spanjolle dhe Ditës Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit në datë 21.04.2022 Departamenti i gjuhës spanjolle, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja zhvilloi një aktivitet ku u lexuan pjesë nga vepra "Don Kishoti i Mançës" e autorit Miguel de Cervantes Saavedra në gjuhë të ndryshme të botës. I pranishëm në aktivitet ishte dhe ambasadori i Mbretërisë së Spanjës në Shqipëri Z. Alvaro Renedo Zalba, i cili falenderoi studentët dhe i inkurajoi për karrierën universitare që kanë zgjedhur.
- Bashkëbisedim me Dr. Flavia Kaba, pedagoge e gjuhës spanjolle mbi përkthimin letrar, librin e fundit të botuar dhe marrjen e çmimit "Përkthyesja më e mirë" në Panairin e Librit 2021. Kolegë dhe studentë të FGjH-së ishin të pranishëm në këtë takim ku u diskutua mbi letërsinë spanjolle, përkthimin letrar dhe sfidat që ndesh përkthyesi në këtë rrugëtim.
- Konferenca ndërkombëtare studentore: të nxënit në shekullin XXI, sfidat dhe perspektivat, datë: 12.05.2022
- Leksion i hapur : "You are worth it!" nga Dr. Edlira Gjoni, për t'i motivuar studentët nëpërmjet historisë së saj të suksesit
- "Metodologjia e vlerësimit në bazë kompetencash në arsimin e lartë", trajnim i ofruar nga Prof.Dr. Andromaqi Haloçi.
- Leksion i hapur me temë : The Geography of Words: the most diverse diversity - mbajtur nga Prof. Danko Sipka (Universiteti Shtetëror i Arizonës, SHBA).
- "Ndikimi i Neuroshkencës dhe Neurogjuhësisë në krijimin e marrëdhënieve pozitive në mësimdhënien post Covid 19", trajnim i ofruar nga Prof. Dr. Shpresa Delija.
- Revista shkencore e FGJH-së, numri 04-2022 në proces botimi; Përmbajtja: artikuj shkencorë origjinalë nga fusha e gjuhësisë, letërsisë, përkthimit, komunikimit, qytetërimit dhe kulturës.
- Aktiviteti me temë "Shumëgjuhësia sot në sistemin parauniversitar dhe universitar, si dhe sfidat e universitetit për përgatitjen e mësuesve të rinj ". Në tryezën e këtij aktiviteti morën pjesë përfaqësues të strukturave politikbërëse nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, ASCAP, kryetarë të shoqatave të mësuesve të gjuhëve të huaja (frënge, angleze, gjermane, italiane), përfaqësues të universitetit publik të Korçës, Elbasanit dhe Shkodrës, profesorë, specialistë dhe mësues të shkollave të mesme nga rrethet dhe Tirana.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I TIRANËS - FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA - TIRANË

## 8. PROJEKTE KERKIMORE

Ngritja e degës së projekteve në FGJH u bë më 1 shtator 2021. Gjate vitit akademik 2021-2022 janë hartuar 15 projekte.

Nga projektet e aplikuara:

8 projekte kanë rezultuar fitues. Donatorët/Financuesit në projektet fituese janë:

- AUF 4 projekte në vlerën 25,090 euro
- MASR 2 projekte në vlerën 402,961 euro
- Bashkia Tiranë 1 projekt në vlerën 6,465 euro
- Universiteti i Tiranës 1 projekt në vlerën 8,621 euro
- Total 9 projekte në vlerën 443,137 euro ekuivalent

Nga këto projekte FGJH përfiton:

- 4 laboratorë (didaktike dhe kërkimi) do të realizohen brenda vitit 2023 me implementimin e një prej projekteve të fituara;
- Rritje të nivelit të ekspertizës të stafit akademik në fushat e aplikuara; shkëmbim eksperience me bashkëpunëtorët e universiteteve partnere; përfshirjen e doktorantëve në kërkim shkencor;
- Edukim të specializuar me impakt të drejtpërdrejtë tek studentët; rritje të kompetencave në menaxhim projektesh për 3 studentë të këshillit studentor në projektin e bashkisë;
- Të gjithë studentët dhe stafi me çeljen e një programi të ri studimi në përkthim automatik të gjuhëve;

| Thirrja | Deadline aplikimi | Titulli i Projektit | Fusha ku aplikohet | Statusi |
